

POLITIKA E PRIVATËSISË

Versioni: 2.2

Data e hyrjes në fuqi: 30.04.2026

Kompania e Sigurimeve SCARDIAN J.S.C. Sh.A., në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (më tutje Ligji) dhe legjislacionin përkatës për sigurime, është e përkushtuar të mbrojë të dhënat personale të klientëve dhe përdoruesve të faqes së internetit. Scardian sipas ligjit është kontrolluesi i të dhënave që përpunon të dhëna për qëllim të ofrimit të shërbimeve tona dhe nuk do t'i përdorë për qëllime tjera të cilat nuk mbështeten në ndonjë bazë ligjore. Ne mbledhim të dhënat personale të subjekteve të të dhënave në momentin e ofrimit të shërbimeve tona, apo nëpërmes vizitës së faqes sonë të internetit.

Ky njoftim i privatësisë bëhet në përmbushjen e obligimeve ligjore të përcaktuara në ligj, me qëllim të ju informojm se si institucioni ynë mbledh dhe përpunon të dhënat personale. Jemi të përkushtuar të zbatojmë kategorikisht të gjithë kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave dhe respektim të çdo veprimi lidhur me të dhënat tuaja.

Kjo Politikë e Privatësisë përshkruan mënyrën se si mbledhim, përdorim, ruajmë dhe mbrojmë të dhënat personale.

- **Identiteti i Kontrolluesit**

Kompania e Sigurimeve SCARDIAN J.S.C.

NUI: 810838138

Adresa: Rr. Perandori Justinian, Nr. 69, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel. 038 777 444, Mobil: 049 777 444

Email: info@scardian.com

- **Qëllimi i përpunimit të të dhënave personale**

Në përputhje me kushtet për përpunimin e të dhënave personale të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit, të dhënat tuaja personale të mbledhura do të përpunohen në kuadër të kryerjes së aktiviteteve të nevojshme nga njësitë tona të biznesit me qëllim për t'ju ofruar dhe administruar produktet dhe policat e sigurimit, ofertimin, lidhjen dhe zbatimin e kontratave të sigurimit, vlerësimin e rrezikut dhe përcaktimin e primit të sigurimit, trajtimin e kërkesave për dëmshpërblim, përmbushjen e

detyrimeve ligjore dhe rregullatore, parandalimin dhe zbulimin e mashtrimeve në sigurime, komunikimin me klientë për shërbimet e sigurimit, marketingun dhe informimin për produkte të reja vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave. Komunikimet tona të marketingut në përgjithësi dërgohen me email, por ndonjëherë mund të përdorim metoda të tjera dërgimi, si me postë ose SMS.

- **Mënyra e mbledhjes së të dhënave personale dhe baza ligjore për përpunimin e tyre**

Ne mbledhim të dhënat drejtpërdrejt nga subjekti i të dhënave përmes formularëve dhe aplikimeve online, apo në raste të caktuara nga përfaqësuesi ligjor (prindi, kujdestari, përfaqësuesi i autorizuar), nga agentët e sigurimit, nga databazat e ligjshme, qendrës së thirrjeve, përmes shërbimeve tona, përfshirë sistemin e brendshëm për menaxhimin e të dhënave të klientëve, përmes postës elektronike, procesit të rekrutimit. Në raste të caktuara, ne mund të mbledhim të dhëna nëpërmes informacioneve dhe dokumenteve të ofruara nga të afërmit tuaj.

Të paktën një nga bazat e mëposhtme duhet të zbatohet sa herë që përpunojmë të dhëna personale:

1.1. **Pëlqimi** - Ne mbajmë pëlqimin e fundit, të qartë dhe të përcaktuar që të dhënat e subjektit të të dhënave të përpunohen për një qëllim të caktuar.

1.2. **Kontratës** – përpunimi është i nevojshëm për të përmbushur një kontratë me individin ose sepse ata na kanë kërkuar të ndërmarrim hapa përpara lidhjes së një kontrate.

1.3. **Detyrimi ligjor** - Përpunimi është i nevojshëm për të përmbushur një detyrim ligjor.

1.4. **Interesi legjitim** - Përpunimi është i nevojshëm për interesat tona legjitime. Ky kusht nuk zbatohet nëse ka një arsye të mirë për të mbrojtur të dhënat personale të individit, e cila tejkalon interesin legjitim.

Në rastet kur përpunimi bazohet në pëlqimin e subjektit, atëherë subjekti i të dhënave ka të drejtë të tërheq pëlqimin e dhënë në çdo kohë.

Ne përpunojmë të dhëna edhe përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë (CCTV), të cilat janë të vendosura për qëllim të sigurisë së objektit, personave dhe ruajtjen e dokumentacionit të ndjeshëm. Përpunimi i të dhënave personale përmes CCTV i nënshtrohet një politike të brendshme që rregullon mënyrën e përpunimit, si dhe masat e sigurisë teknike dhe organizative të këtij sistemi.

- **Kategoria e të dhënave personale**

Ne përpunojmë të dhënat personal për t'i ofruar shërbimet tona ose kur kjo kërkohet me ligj. Kategoria e të dhënave personale që do të përpunohen varet nga shërbimet e kërkuara dhe produktet që përdorin klientët. Për shembull, nëse dëshironi të merrni ofertë për produktet tona të sigurimit, duhet të jepni emrin dhe mbiemrin tuaj, numrin e telefonit, adresën e postës elektronike. Të dhënat personale varësisht nga shërbimi dhe kategoria e subjekteve të të dhënave, mund t'i takojnë kategorive të ndryshme si: të dhëna identifikuese (emër, mbiemër, datëlindje, numër personal); të dhëna të kontaktit (adresë, email, telefon); të dhëna financiare dhe të pagesave; të dhëna për automjetin ose pronën e siguruar; të dhëna teknike (IP adresë, cookies); të dhëna shëndetësore në rastin e sigurimeve shëndetësore ose aksidenteve; imazhe nga sistemi CCTV për qëllime sigurie, të dhënat që merren përmes ankesave për realizimin e të drejtave, të dhënat për fëmijët vetëm pas marrjes së pëlqimit me shkrim nga prindërit.

- **Profilizimi dhe vendimarrja e automatizuar**

Në disa raste, kompania mund të përdorë procese automatike për vlerësimin e rrezikut të sigurimit dhe përcaktimin e primit të sigurimit. Këto procese bazohen në të dhëna statistikore dhe modele analitike. Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kërkojnë ndërhyrje njerëzore dhe të kundërshtojnë vendimet që bazohen vetëm në përpunimin e automatizuar.

- **Parandalimi i mashtrimeve dhe AML**

Për të mbrojtur interesat e kompanisë dhe të klientëve, SCARDIAN mund të përpunojë të dhëna personale për qëllim të parandalimit dhe zbulimit të mashtrimeve në sigurime, si dhe për përmbushjen e obligimeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

- **Ruajtja e të dhënave**

Të dhënat personale ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për realizimin e qëllimeve për të cilat janë mbledhur. Në rastet kur përpunimi bazohet në kontratë, të dhënat ruhen gjatë gjithë periudhës së marrëdhënies kontraktuale dhe deri në 10 vite pas përfundimit të kontratës së sigurimit.

Të dhënat e kandidatëve potencial për punësim do të ruhen 1 muaj pas përfundimit të procesit, pas këtij afati do t'i kthehen kandidatit apo do të shkatërrohen; të dhënat e marra përmes CCTV do të ruhen për një periudhë maksimale prej 30 ditëve. Ne jemi të përkushtuar që respektojmë parimet e Ligjit.

- **Transferimi ndërkombëtar i të dhënave**

Nëse të dhënat personale transferohen jashtë Republikës së Kosovës, kjo bëhet vetëm në përputhje me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe me garanci adekuate për mbrojtjen e tyre. Me rastin e përmbushjes së qëllimit të përpunimit, të dhënat personale asgjësohen, fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime, përveç nëse është paraparë ndryshe me ndonjë ligj tjetër përkatës. Transferimi i të dhënave do të bëhet me pëlqimin e subjekteve, por edhe bazuar në interesin legjitim me rast që nuk tejkalon të drejtat e subjekteve. Për transferimin e të dhënave në vendet që nuk gjinden në listën e Agjencisë për Informim dhe Privatësi që sigurojnë nivel të duhur të mbrojtjes, e që janë vendet e BE-së dhe disa vende të zhvilluara, për ato vende që nuk sigurojnë nivel të duhur të sigurisë së të dhënave, ne do të kërkojmë autorizim nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.

- **Përpunimi nga palët e treta**

Kompania mund të kontraktojë përpunues të të dhënave për shërbime teknike, IT, hosting, pagesa elektronike dhe shërbime të tjera të lidhura me sigurimet. Përpunimi nga palët e treta kryhet vetëm në bazë të një kontrate për përpunimin e të dhënave. Ne nuk do t'i transmetojmë të dhënat një pale të tretë, përveç nëse kjo është paraparë me ndonjë ligj specifik dhe paraqet obligim ligjor për ne.

- **Të drejtat e subjektit të të dhënave**

Subjektet e të dhënave kanë të drejta të cilat i garanton ligji, për të cilët ne i respektojmë sa më mirë që kemi mundësi. Ne sigurojmë që subjektet e të dhënave të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe përmes kësaj politike të dinë se cilat të drejta janë të garantuara. Subjektet e të dhënave kanë këto të drejta:

E DREJTA PËR T'U INFORMUAR – ju keni të drejtë të informoheni përmes politikave të privatësisë apo komunikimit me kontrolluesin lidhur me atë se si përpunojmë të dhënat tuaja. Ky njoftim/komunikim duhet të jetë konciz, transparent, i shkruar në një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë.

E DREJTA E QASJES – ju keni të drejtë të keni qasje në të dhënat e tuaja personale dhe informacione shtesë. Përmes kësaj të drejte keni të drejtë të verifikoni ligjshmërinë e aktiviteteve të përpunimit që po ndërmerren për të dhënat tuaja personale dhe të kërkojnë qasje në ato të dhëna. Gjithashtu keni të drejtë të merrni një kopje të dhënave tuaja.

E DREJTA PËR KORRIGJIM – keni të drejtën për korrigjimin e të dhënave personale të pasakta në lidhje me ju. Duke marrë parasysh qëllimet e përpunimit, keni të drejtën t'i plotësoni të dhënat personale të paplota, pasakta duke përfshirë nëpërmjet bërjes së një deklarimi shtesë. Ne duhet të korrigjojmë ose ndryshojmë të dhënat personale të një individi nëse kërkohet sepse ato janë të pasakta ose të paplota.

E DREJTA E FSHIRJES – keni të drejtë të kërkonit të bëjmë fshirjen e të dhënave tuaja, nëse plotësohen kriteret e nenit 16 të Ligjit dhe nuk ka asnjë arsye bindëse për përpunimin e tyre të vazhdueshëm.

E DREJTA PËR TË KUFIZUAR PËRPUNIMIN – keni të drejtë të kërkonit të bëjmë kufizimin, bllokimin e të dhënave tuaja. Ne lejohejmë të ruajmë të dhënat personale nëse ato janë kufizuar, por jo t'i përpunojmë më tej. Ne duhet të ruajmë mjaftueshëm të dhëna për të siguruar që e drejta e kufizimit të respektohet në të ardhmen.

E DREJTA PËR TRANSPORTUESHMËRI TË TË DHËNAVE - keni të drejtë të merrni të dhënat personale që ne përpunojmë për ju dhe t'i ripërdorni ato për qëllimet tuaja, siç janë ruajtja e tyre për përdorim personal ose transmetimi i tyre te një kontrollues tjetër i të dhënave. Ne do t'i ofrojmë ato në një format të përdorur zakonisht, të lexueshëm nga makina, dhe ta dërgojmë drejtpërdrejt te një kontrollues tjetër nëse kërkohet.

E DREJTA PËR TË KUNDËRSHTUAR – keni të drejtën e plotë të kundërshtimit në rastet e caktuara, sidomos kur përpunimi i të dhënave bazohet në pëlqimin tuaj.

TË DREJTAT NË LIDHJE ME VENDIMMARRJEN DHE PROFILIZIMIN E AUTOMATIZUAR - Ju keni të drejtë të kërkonit që të mos jeni subjekt i një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar, duke përfshirë profilizimin.

- Këto të drejta, mund të kufizohen në rastet e caktuara në nenin 22 të Ligjit, si shembull: të drejtat tuaja mund të kufizohen në masë të caktuar dhe proporcionale për të garantuar sigurinë shtetërore; mbrojtjen, sigurinë publike, parandalimin dhe hetimin e veprave penale, mbrojtjen e pavarësisë gjyqësore, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, ekzekutimin e pretendimeve sipas së drejtës civile etj.

- Ne do të trajtojmë kërkesat për të drejtat e subjektit pa vonesa të panevojshme brenda një muaji kalendarik. Megjithatë, ne mund të zgjasim kohën për t'u përgjigjur edhe për dy muaj të tjerë nëse kërkesa është komplekse ose ne kemi marrë një numër kërkesash nga individ. Ne duhet të ju njoftojmë brenda një muaji nga marrja e kërkesës dhe të shpjegojmë pse zgjatja është e nevojshme.

- Të drejtat tuaja mund t'i realizoni duke plotësuar formularin [[bashkëlidh linkun e formularit për realizimin e të drejtave sipas Politikës për trajtimin e kërkesave të subjektit të të dhënave-KDS](#)]

- Në rastet e parashtimit të kërkesës tuaj, ne mund të kërkojmë informacione shtesë për të vërtetuar identitetin tuaj.

- **Siguria e të dhënave**

SCARDIAN zbaton masa teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë kontrollin e qasjes, enkriptimin, monitorimin e sistemeve dhe trajnimin e stafit.

- **Paraqitja e ankesës**

Nëse konsideroni se përpunimi i të dhënave tuaja nuk është në përputhje me ligjin, kini të drejtë të paraqisni ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi (<https://aip.rks-gov.net>).

- **Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave**

SCARDIAN a caktuar Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të monitoruar përputhshmërinë me ligjin dhe për të trajtuar kërkesat që lidhen me përpunimin e të dhënave personale. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mund të kontaktohet përmes: (mdp@scardian.com)

- **Përditësimi i politikës**

Kjo Politikë e Privatësisë mund të përditësohet herë pas here për të reflektuar ndryshimet ligjore ose operacionale. Versioni më i fundit publikohet në faqen zyrtare të kompanisë.